



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Emri i biznesit: Habib Zogaj B.I.
Emri Tregtar: Radio "Malisheva"
Numri Unik Identifikues: 810706161
Pronar: Habib Zogaj
OSHMA: Radio Malisheva
Adresa: Rr/ "Habib Berisha" nr.50, Malishevë



VENDIM

për ripërtëritjen e licencës të Ofruesit të Shërbimeve Mediale Audio – Radio Malisheva, me seli në Malishevë

Fakte

1. Komisioni i Pavarur për Media (KPM), është organ i pavarur i cili është kompetent për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit. KPM-ja rregullon të drejtat, detyrimet si dhe përgjegjësitë e personave fizik dhe juridik të cilët ofrojnë shërbimet mediale audio dhe audio vizuale.
2. Radio Malisheva është Ofrues i Shërbimeve Mediale Audio me pronarë Habib Zogaj, me mbulim lokal, i cili është licencuar nga Komisioni i Pavarur për Media (KPM), për transmetim tokësor analog të programeve të radios, me seli në Malishevë. KPM, me vendimin e datës 06 tetor 2016, lëshimin e licencës së Radio Malisheva për një afat prej shtatë (7) vitesh, ndërsa më datën 06 tetor 2023, skadon afati i licencës së Radio Malisheva.
3. Me datën 18 prill 2023, KPM përmes e-mail ju ka dërguar shkresë të gjitha radiove të cilave afti i licencës ju skadon licenca në vitin 2023, në mesin e tyre edhe Radio Malisheva, përmes së cilës shkresë i ka njoftuar lidhur me skadimin e afatit të licencës dhe mundësin e ripërtëritjes së saj në pajtim me Nenin 25 të Ligji Nr. 04/L-44 për Komision i Pavarur të Mediave.
4. Më datën 18 maj 2023, Radio Malisheva ka dorëzuar një kërkesë me shkrim në Zyrën Ekzekutive të KPM-së, përmes së cilës ka kërkuar ripërtëritjen e licencës

Arsyetim

5. Neni 25 i Ligjit të KPM-së përcakton: *Përveç rasteve kur KPM-ja konsideron se licenca nuk duhet të ripërtëritet për shkak të shkeljes së dispozitave materiale nga ana e ofruesit të shërbimit medial audio vizual privat për sa u përket kushteve dhe kriterëve të licencimit, kandidati ka të drejtë të kërkojë përtëritjen e licencës nga Komisioni brenda gjashtë (6) muajve para skadimit të datës së licencës ekzistuese dhe minimum gjashtëdhjetë (60) ditë para skadimit të licencës.*

6. Me anë të shkresës së datës 18 prill 2023, lidhur me njoftimin për skadimin e afatit të licencës, KPM gjithashtu, ka njoftuar Radio Malisheva lidhur me dokumentacionin e nevojshëm për ripërtëritjen e licencës, ndërsa përmes e-mail-i e ka njoftuar lidhur me dokumentacionin shtesë të nevojshëm.
7. Komisioni konstaton se, Radio Malisheva përmes kërkesës me shkrim ka shprehur interesim për vazhdimin e veprimtarisë së ofrimit të shërbimeve mediale audio (radio) në lokacionin për të cilin është licencuar.
8. Komisioni konstaton se Radio Malisheva ka shlyer të gjitha obligimet financiare ndaj KPM - së, përfshirë këtu edhe pagesën e tarifës administrative për ripërtëritje të licencës, e paraparë me Rregulloren KPM-2017/06.
9. Komisioni konstaton se sipas certifikatës së biznesit të dorëzuar si pjesë e kërkesës për ripërtëritje të licencës, nuk ka ndryshim të pronësisë së Radio Malisheva, ku figuron emri i pronarit sipas licencës z. Habib Zogaj. Gjithashtu, certifikata përmban edhe kodin e veprimtarisë për transmetimin e programeve të radios.
10. Komisioni konsideron se nuk janë evidentuar shkelja të tilla të dispozitave materiale të Ligjit dhe akteve nënligjore të KPM-së, nga ana e ofruesit të shërbimit medial, Radio Malisheva të cilat shkelje do të pamundësonin ripërtëritje e licencës.
11. Komisioni vlerëson se kërkesa për ripërtëritjen e licencës së Radio Malisheva është dorëzuar në pajtim me dispozitat ligjore të parapara me Ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së dhe si e tillë kërkesa për ripërtëritjen e licencës së Radio Malisheva i plotëson kushtet për miratim dhe se ripërtëritja e licencës është në interesin e publikut në zonën në të cilën transmeton kjo radio.

Vendim

12. Komisioni merr vendim për miratimin e kërkesës për ripërtëritjen e licencës së Radio Malisheva, në mënyrë që të vazhdoj me veprimtarinë e ofrimit të shërbimeve mediale audio, e cila veprimtari është në interes të publikut në lokacionin për të cilin është licencuar dhe në të cilin është duke transmetuar program Radio Malisheva.
13. Licenca e Radio Malisheva do të jetë e vlefshme për një afat prej shtatë (7) vitesh, ashtu siç është përcaktuar me Nenin 21, paragrafin 2, të Ligjit për KPM-në, ndërsa vlefshmëria e afatit të licencës do të llogaritet nga data 06 tetor 2023.
14. Të gjitha parametrat e licencës së Radio Malisheva, siç janë: kategoria e të licencuarit, skema programore, parametrat teknike dhe harta e zonës së mbulimit do të mbesin të pandryshuar nga licenca paraprake.
15. Këtë vendim e lëshon Komisioni dhe i njëjti hyn në fuqi nga data e nënshkrimit.



Jeton Mehmeti
Kryetar
Komisioni i Pavarur i Mediave



10. 11. 2023

Datë